

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 168, Tetor 2017

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## UZHVILLIA KONFERENCA SHKENCORE "100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin"

Më datën 14 tetor 2017, për rreth katër orë në sallën e konferencave të rektoratit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" zhvilloj punimet Konferenca shkencore "100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin" organizuar nga kryesia e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini". Merrnin pjesë shumë të ftuar nga komuniteti dukagjin, personalitete të shkollës dhe kulturës të Bashkisë Shkodër, Kryetarja e bashkisë Shkodër Voltana Ademi, nënkryetari i këshillit të Qarkut Shkodër Maxhid Cungu, përfaqësuesja e Ministrisë së Kulturës Majlinda Laçej, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit të qarkut Shkodër Kadri Ymeraj, rektori i Universitetit të Shkodrës Adem Bektashi, i dërguari i Monsinjor Angjela Masafra, Dr. Dom Nik Ukgjini. Ishin të pranishëm edhe të ftuar edhe nga shoqata Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" zotrinjtë, Ukshin Jashari dhe Frashër Racaj, nga gjimnazi natyror profesional "Skënderbeu" Kaçanik Ibish Vishi, kryetari i veprimtarisë letrare "Ora e Maleve" Rozhajë Ali Daci, Kryetari i shoqata "Nikaj-Mëërturi" Gjin Nikleka, përfaqësuesi i shoqatës "Mirdita" Gjan Bruçi, shoqata Malësia e Madhe Nderi i Kombit" Sytki Ndreca, shoqata atdhetare "Postripa", Kadri Fikaj, Shoqata patriotike "Spani" Mhill Pali, Shoqata "Treva" Fran Kodra.



## ROBERT ELSIE VARROSET NE 'THEH'

10

Më 18 tetor 2017, Dr. Robert Elsie varroset ne Theth sipas dëshirës së tij. Varrimi u bë me të gjitha nderet tradicionale te krahinës. Trupi i tij u vendos në banesën e fundit në varret e fshatit Theth. Sipas traditës katolike, arkivoli me trupin e tij beri një qëndrim në kishën e fshatit, ku u thanë uratët e përshpirtjes, pastaj i bartun në duar, në shenjë respekti, arkivoli me trupin e tij bëri udhëtimin e fundit për në banesën e përgjeshme. Mbi varrin e tij u vendosën kiurora dhe shumë tufa me lule natyrale nga shumë banorë. Mbi varrin e Dr. Robert Elsie u vendosën edhe kurorat ...



## PREL MILANI, PËRSËRI NË BILIOTEKËN "MARIN BARLETI"

11

Me datën 8 tetor 2017, ditë e diele, mjedis i promovimit të librave, në bibliotekën "Marin Barleti", ishte plotë e për plotë me shkrimtar, poet, studiues e dashamirë të artit të shkruar, anëtar të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", miq e mike të poetit, studiuesit e publicistit Prele Milanit, si dhe familjar të tij.

Drejtori i Bibliotekës "Marin Barleti", z. Gjovalin Çuni, Shoqata e shkrimtareve Shkodër dhe Shoqata Atdhetare "Dukagjini", te tre së bashku organizuan ceremoninë e promovimit të dy librave të Preles, një vëllim me poezi satirike, me titull "Burrat vdiqën, të na rrojnë gratë" dhe libri, me titull "Zoja e Berishës".

Ceremoninë e hapi zot Gjovalin Çuni, i cili pasi i beri një ekspozitë të gjere të veprimtarisë krijuese të Preles, ja dha fjalën Kryetarit të Shoqatës së shkrimtareve të Shkodrës, poetit Skënder Temali. Pastaj dhanë opinionet e tyre, Ndue Sanaj, Lazer Kodra, Qazim Çela, Kadri Ujkaj, Mimoza Rexhvelaj...

## Konferencë shkencore: 100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

# UZHVILLIA KONFERENCA SHKENCORE - 100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin -

Më datën 14 tetor 2017, për rreth katër orë në sallën e konferencave të rektoratit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" zhvilloj punimet Konferenca shkencore "100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin" organizuar nga kryesia e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini". Merrnin pjesë shumë të ftuar nga komuniteti dukagjinasi, personalitete të shkollës dhe kulturës të Bashkisë Shkodër, Kryetarja e bashkisë Shkodër Voltana Ademi, nënkryetari i këshillit të Qarkut Shkodër Maxhid Cungu, përfaqësuesja e Ministrisë së Kulturës Majlinda Laçe, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit të qarkut Shkodër Kadri Ymeraj, rektori i Universitetit të Shkodrës Adem Bekteshi, i dërguari i Monsinjor Angjela Masafra, Dr. Dom Nik Ukgjini. Ishin të pranishëm edhe të ftuar edhe nga shoqata Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" zotrinjtë, Ukshin Jashari dhe Frashër Racaj, nga gjimnazi natyror profesional "Skënderbeu" Kaçanik Ibish Vishi, kryetari i veprimtarisë letrare "Ora e Maleve" Rozhajë Ali Daci, Kryetari i shoqatës "Nikaj-Mëerturi" Gjini Nikleka, përfaqësuesi i shoqatës "Mirdita" Gjan Bruçi, shoqata Malësia e Madhe Nderi i Kombit "Sytki Ndreca", shoqata atdhetare "Postripa", Kadri Fikaj, Shoqata patriotike "Spani" Mhill Pali, Shoqata "Treva" Fran Kodra.

Ishin të ftuar edhe shumë mësues dhe ish mësues në vite në krahinë e Dukagjinit, mësues të vjetër, punonjës të kulturës dhe këngëtar e instrumentistë të folklorit popullor të krahinës, artizan popullor në fusha të ndryshme, veprimtarë të kulturës, shkrimtarë dukagjinasi dhe për Dukagjinin.

Konferencën e hapi kryetari i Shoqatës "Atdhetare Dukagjini", Ndue Sanaj. Pas falnderimeve të rastit për pjesëmarrësit, filloj punimet konferenca. Sipas programit, u fillua me referatin "100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin" paraqitur nga Luigj Shyti, pastaj u kalua në kumtesa. Kumtesën me temë "Reforma arsimore e vitit 1946 dhe roli i konvikteve në Dukagjin" u mbajt nga z. Prelë Shytani, ajo me temë mbi punën kulturore në Dukagjin në vite u mbajt nga Fran Kodra, kumtesën mbi punën e



bërë dhe rëndësinë e gazetës "Dukagjini" përgatitur Ndue Sanaj, mbi përhapjen dhe rolin e arsimit të mesëm në Dukagjin është përgatitur nga Zef Fusha, puna dhe roli i mësuesve në përhapjen e kulturës në fshat, përgatitur nga Tereze Brigja, mbi rolin e klerit katolik në hapjen e shkollave në gjuhën shqipe në Dukagjin dhe vlerën e tyre përgatitur nga Gjyste Shyti, mendime dhe konkluzione rreth studimeve arkeologjike në Luginen e Shalës, mbajtur nga arkeologu Zamir Tafilica. Konferencës i dhanë freski dhe emocione mjaft kujtime të hollësishme të ish mësuesve në vite në Dukagjin, të cilët e konsideronin punën dhe jetën në këtë krahinë si një universitet të dytë. Kanë përgatitur dhe paraqitur kujtimet e tyre nga puna dhe jeta në këtë krahinë, Prof. Gjavlin Kolombi, Kadri Ujkaj, Kolë Funiçi, Muhamet Ganjolla, Muhmet Shalla, Ndoc Odri, Ndue Vata, Paulin Pero, Ruzhdi Poda, Sebiha Kopliku, Zef Bari. Nuk po zgjatemi në hollësi rreth këtyre punimeve, sepse së shpejti do të botohen në një vëllim të posaçëm dhe do të jenë në dorën e lexuesit.

Krahas materialeve të paraqitura, në pushimin midis seancave u vizitua edhe nje fotoekspozitë me fotografi të mbledhura në vite, e përgatitur sistemuar dhe redaktuar me kujdes nga Aleks Dushi, e cila pati mjaftë interes për të pranishmit.

Në mbydhje të Konferencës kryetari i Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" Ndue Sanaj komunikoj propozimin që i është bërë nga kryesia e shoqatës Presidentit të Republikës për dekorimin e piktorit Ndoc Martini me dekoratën "Mjeshtër i Madh", piktorin Zef Shoshi me dekoratën "Mjeshtër i Madh", familjen Mjetaj nga Xhani-Pult me titullin "Naim Frashëri", Familjen e Gjokë Pjetër Marku nga Nënnavriqi me dekoratën "Për merita të veçanta civile", si dhe dhënie e medalionit nga shoqata "100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin" 200 mësuesve dhe ish mësuesve në vite, që punuan në Dukagjin, punonjësve të njohjes dhe trashëguesve të folklorit tradicional të krahinës së Dukagjinit, artizanëve dhe mjeshtrave të kulturës materiale popullore, publikuesve nëpërmes ekranit dhe medias elektronike të kulturës dhe veçanërisht të asaj dukagjionase, autorëve të botime nga Dukagjini dhe për Dukagjinin, atyre që vunë në dispozicion pronë të tyre pa shpërblim për ndërtim shkolle dhe veprimtarë të shoqatës në realizimin e programit të saj kulturor.

Kjo Konferencë arriti shumë mirë objektivin e saj.

Për miqtë nga jashtë Shqipërisë u shtrua një drekë.

Korespondenti i gazetës "Dukagjini"  
14.10.2017

## Konferencë shkencore: 100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

# Hjala e hapjes së Konferencës



**Të nderuar mësuese dhe mësues!  
Të nderuar të pranishëm!  
Të nderuar miq!  
Zonja e zotërinj!**

E ndjeje veten shumë të nderuar, që në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", të hap punimet e Konferencës – Shkencore, me temë: "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin".

Shoqata Atdhetare "Dukagjini", me 13 maj 2003 ka datëlindjen. Pas pak muajsh do të festojë 15 vjetorin e themelimit të saj. Ajo ka punuar me një mision të qartë, i cili ka qenë dhe është: "Duke u mbështetur në historikun e së kaluarës dhe të sotmes, duke respektuar ndjenjat dhe sakrificat e të parëve për liri e pavarësi, Dukagjini të zërrë më mire vendin që meriton në Botën e qytetëruar e moderne".

Në funksion të këtij misioni është punuar jo pak, duke pasur parasysh një shprehje filozofike, që thotë: "Mos shko aty ku të shpie shtegu, por shko atje ku nuk ka shteg dhe lër gjurmë!", duke pasur parasysh mendimin "Mos pyet se çfarë bëri Dukagjini për ty, por çdo ditë pyet se çfarë bëra unë për Dukagjinin", si dhe duke pasur në themel të punës së saj vullnetarizmin. Me këtë punë vullnetare, në themel të cilës janë pasur parasysh morali i këtyre shprehjeve filozofike, janë përgatitë dhe zhvilluar shtatë simpoziume apo konferenca shkencore dhe një seminar shkencore, me një temë të përgjithshme: "Dukagjini në rrjedhat e historisë".

I pari, kushtuar 85 vjetorit të Besës së Prekalit, me temë "Kuvendet Malësore dhe koha

I dyti, kushtuar 95 vjetorit të Luftës së Qafës së Agrit, 90 vjetorit të Luftës së Planit dhe 90 vjetorit të rënies së heroit të Dukagjinit, Mehmet Shpendit, me temë "Traditat patriotike dhe liridashëse të dukagjinaseve në vitet 1890 - 1920",

I treti, kushtuar 100 vjetorit të lindjes, një figure të mëdha të Dukagjinit dhe të Shqipërisë, At' Jak Marleka (prof. dr. Luigj Marleka), me temë "Një misionar në Shërbim të Kombit",

I katërti, kushtuar vlerave materiale dhe shpirtërore të dukagjinaseve, me temë: "Kultura materiale e shpirtërore",

I pesti, kushtuar femrës dukagjinase,

me temë: "Femra dukagjinase në kohe", I gjashti kushtuar gjakmarrjes, me temë: "Gjakmarrja retorike apo realitet", në bashkëpunim me Komisionin Drejtësi e Paqe,

I shtati, është përgatitur e zhvilluar Konferencë përkujtimore, në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, në bashkëpunim me shoqatën "Martin Dreshaj", me qendër në Peje.

Seminari shkencor është përgatitur e zhvilluar me temë: "Drejtimet e mundshme të zhvillimit të Dukagjinit".

Janë paraqitë apo promovuar 67 libra të autorëve dukagjinase e jo dukagjinase, por që kanë shkruar për Dukagjinin e dukagjinasi. Pa llogaritur gjithë ato veprimtari përkujtimore, kulturore e artistike të zhvilluar në bashkëpunim me shoqatën apo ansamblin "Treva", në teatrin "Migjeni". Pa llogaritur këtu nxjerrjen e 167 numra të gazetës "Dukagjini", që nga muaji dhjetor i vitit 2003, që ka dalë numri i parë i saj pa u ndërprere asnjë muaj, pa renditur dhjetëra veprimtari të Shoqatës në Shqipëri, në Kosovë e në mjedisin e shqiptarëve në republikën e Malit të Zi. Prandaj, në emrin tuaj, të anëtarëve

sisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" ju shpreh mirënjohjen e thellë për kontributin intelektual që kanë dhënë të gjithë ata e ato në realizimin e këtyre veprimtarive të Shoqatës, që i kanë shërbyer realizimit të misionit të saj.

Sigurisht asgjë nuk është bërë pa kontributin financiar të qindra dukagjinaseve, në veçanti bashkësia dukagjinase në Nju-Jork, Gjergj Leqezja në Shkodër, Ndue Ftoni në Miçigan, Kole Çardaku, Mhill Prroni e Prenda Shpendi, Sokol Cubin e Pal Gjolaj, Bal Vuksanin e Pal Troshani, Roza Pjetri, Gjergj Vocaj e Mitër Ndreshaj, Anton Kosteri, Tonin Marku e Edmond Terthorja, Ndue Shurlaj, Martin Martini, Vat Musa e Tome Shpendi, Mark Zhuri, Agron Hasanaj e Hil Kodra e shumë e shumë të tjerë e të tjerë, që nga Ministria e Kulturës, që në vitin 2007 dhe në këtë vit na ka vlerësuar e na ka mbështetur moralisht e financiarisht. Të gjithë, nga kjo tribunë e nderuar, në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" i falënderoj dhe i uroj me shprehjen popullore "Paçin faqen e bardhë! Paçin e dhënçin!"

Edhe veprimtaritë e realizuara

në kuadrin e 100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin, së bashku me këtë Konferencë janë realizuar në saj të kontributit financiar të Ministrisë Kulturës, që është e vetmia Ministri që na ka mbështet e vijon të na mbështes në realizimin e misionit të Shoqatës; të anëtarëve të Shoqatës Edmond Terthorja, Kole Çardaku, Anton Kosteri, Agron Hasanaj, Arber Raja, Tonin Marku, Elvis Ndreshaj e Marash Mici; të simpatizantëve Paulin Qeta, Pëllumb Zozja e Mikel Kopsaj, të profesor Zef Gjeta, të etnografes File Strugaçi e të përhershmit, N/Kryetarit të Shoqatës, zotit Gjergj Leqezja dhe të anëtarit të kryesisë së Shoqatës, të zotit Mhill Prroni, të cilët i falënderojmë dhe i urojmë me shprehjen popullore "Paçin e dhënçin!"

Gjithashtu, kjo konferencë është përgatitur edhe në saj të mbështetjes që na ka dhënë Rektori i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", zoti Adem Bekteshi, të cilin e kemi edhe në mesin tonë. Gjithashtu mbështetje na ka dhënë dhe Drejtori Rajonal i Arsimit, zoti Kadri Ymeri. Zotërinj ju falënderojmë për mbështetjen që na keni dhënë dhe besojmë se edhe në të ardhmen kjo mbështetje do të jetë më e plotë.

I cilësova, këto arritje në mënyrë të përmbledhura, për të sjellë para jush, se në këtë konferencë, në konferencën e tetë shkencore, nuk vijmë rastësisht. Vijmë në këtë Konferencë pas një pune kolosale që është bërë në këto vite nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini".

Të nderuar, kemi rreth dy vjet, që kryesia e shoqatës ka marre vendimin për të përgatitur këtë Konferencë dhe është bërë jo pak punë. Komisioni i përgatitjes së kësaj konference, i drejtuar nga z. Luigj Shyti, ka punuar me shumë përkushtim, me shumë profesionalizëm për të arritë në këtë ditë.

Në këto moment, kujtoj mësuesit e mi, që në klasën e parë fillore dhe deri pedagogët në Akademinë e Lartë Ushtarake. Njeri prej të cilëve është këtu, në mes nesh, i ftuar për të marre pjesë në këtë konference. Ky është mësuesi im, i klasës së shtatë, në fshatin Shënkolle të Bregut të Matës, në Lezhë, i nderuari Eqrem Kruja. I nderuar mësues Eqremi, dhe nëpërmjet jush, ju dërgojmë MIRËNJOHJEN e madhe, Mirënjohjen e thellë gjithë armatës së pafundme të mësuesve e mësuesve gjatë këtij shekulli, për punën që keni bërë duke mos u ndalur në asnjë moment për dhënien mësim, për dhënien dituri fëmijëve, në mes tyre dhe mua.

Rrënjët arsimit e kulturës sonë i gjejmë, që në lashtësinë e hershme, historia e zhvillimit të shkollave shqipe, dhe e arsimit tonë në Shkodër daton që nga 1345-1395 dhe në Pult 1367, Shkolla këto të hapura



# Konferencë shkencore: 100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

nga Françeskanet arbëror, dhe ata italian që e dinin gjuhën shqipe, pranë kishave dhe kuvendeve duke filluar, nga shkolla në Ulqin - 1258, dhe në vazhdimësi në Durrës-1278, Tivar-1349, Drishtë-1396, Stubëll, Dibër, Prizren, Shkup, Elbasan, Ohër e të tjera. Shkolla këto të hapura nga Kisha arbërore dhe françeskanët ku i zhvillonin të gjitha ritet fetare në gjuhën shqipe, populli merrte pjesë më dëshirë në meshë, në kuvende, pagëzime, kreshmët, në celebrimin e martesave, ku françeskanët kontribuuan edhe në hapjen e shkollave shqipe, sipas shkrimit "Urdhri Françeskan në Shqipëri", siç thekson Prof. Dr. Lutfi Alia, në gazetën "Zemra Shqiptare", botuar në gazetën "Zemra Shqiptare", me datën 1, 7, 20 korrik 2013 dhe 2 maj e 7 qershor 2015

Pra, të nderuar mësuese e mësues, ketë konferencë e kemi përqendruar në hapjen e pare të shkollës shqipe në tre fshatra në zonën e Dukagjinit, në vitin 1917, që janë njohur nga shteti shqiptar. Kështu, 100 vjet më pare u hapen tre shkollat e para shqipe në zonën e Dukagjinit, dhe në të tria u mësua në gjuhën e nënës, në shqip; filloi të shkruhej e të lexohej shqip. Ata që i hapen këto tre shkolla janë dy fretër, dy fretër jashtëzakonisht atdhetar, shumë shqiptar, që nuk kursyen asgjë, as jetën në shërbim të shqiptarisë duke realizuar gjënë më të veçantë, atë, që fëmijët e malësorëve dukagjinasi të mësonin të shkruhej e të lexonin në gjuhën e nënës së tyre, të ndaluar për rreth 4 shekuj e gjysmë me radhe nga pushtuesi osman. Këta ishin, i madhi At' Shtjefen Gjeçovi, që në fshatin Theth, me 2 shkurt 1917 dhe në fshatin Prekal, me 17 shtator të atij viti, hapi shkollën në gjuhën shqipe; dhe i madhi At' Justin Rrota, që në fshatin Plan, me 1 dhjetor 1917 hapi shkollën në gjuhën shqipe.

Nga ky viti, sigurisht here me vijimësi e here me ndërprerje, me problemet e tij, me problemet e secilës periudhe, arsimit e kultura në Dukagjin filluan të ecin në gjuhën shqipe, duke u zhvilluar deri në ditët e sotme.

Ne, me datën 23 shtator 2017 vendosëm pllakën përkujtimore në Kishën e Thethit, me mbishkrimin "Këtu, At' Shtjefen Gjeçovi, me 2 shkurt 1917 hapi shkollën shqipe"

Ne, me datën 24 shtator 2017, vendosëm pllakën përkujtimore në Kishën e Planit, me mbishkrimin "Këtu, At' Justin Rrota, me 1 dhjetor 1917 hapi shkollën shqipe". Po në këtë datë, vendosëm pllakën përkujtimore, në Qelën e Kishës së Prekalit, me mbishkrimin "Këtu, At' Shtjefen Gjeçovi, me 17 shtator 1917 hapi shkollën shqipe". Këto pllaka përkujtimore u vendosën në bashkëpunim me Imzot, Monsinjor Angelo Massafra, me administratorët e Njesisë administrative Shalë, Pult e Postribë, respektivisht Petrit Arra, Tome Ndoka e Altin Shabaj, dhe me kryepërgjigje të këtyre fshatrave, zotin Marash Rrgalla, Pjeter Thani e Marash Pjetri.

Për këtë histori të kësaj pune të jashtëzakonshme, për gjatë këtij shekulli, është përgatitur një referat, 7 trajtesa, dhe do të ligjërohen disa kujtime



nga mësues e mësuese veteran, si dhe nga punonjës të artit e të kulturës gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar e deri në ditët e sotme.

Në pushimin në mes të pjesës së parë e të dytë të kësaj konferencë do të shikon një ekspozitë të thjeshtë, me të cilën u bënë përpjekje të pasqyrojmë historinë e shkollës sonë 100 vjeçare dhe të brezave në fushën e kulturës. Pra, vetëm atë sikur të kishim paraqitë dhe të ishim ndalur vetëm këtu, do të ishte e mjaftueshme për të treguar atë punë të madhe që është bërë në këto 100 vite. Pavarësisht nga kjo, janë përgatitur dhe ligjërimet përkatëse, për të cilat e kishim dëshirën ti kishit përpara, në një libër të veçantë, por më vonë u mendua, se është më e rregullt të botohen pas Konferencës, me titull "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin". Dhe kështu do të bëhet.

Të nderuar të pranishëm, përpara se të fillojnë punimet e kësaj konferencë, më lejoni t'iu ftoj, të ngriheni në këmbë dhe në shenjë respekti e mirënjohjeje për gjithë ata mësues e mësuese, për të gjithë ata krijues e artistë popullor, për të gjithë ata punonjës të kulturës, që nuk jetojnë më, të mbajmë një minutë heshtje!

Zonja e zotërinj, ketë konferencë e nderojnë, me pjesëmarrjen e tyre miq nga Kosova; përfaqësues të Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe, e pagëzuar me emrin "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë, te kryesuar nga kryetari i saj, Ukshin Jashari;

Përfaqësues të gjimnazit profesional natyror, i pagëzuar me emrin e Heroit Kombëtar "Skënderbeu", në Kaçanik, të kryesuar nga drejtori i kësaj shkolle, profesor Ibush Vishi;

Kryetari i veprimtarisë letrare "Ora e Maleve", nga Rozhaja, zoti Ali Daci;

Rektori i Universitetit të Shkodrës "Lui-gj Gurakuqi", Prof. Dr. Adem Bekteshi;

Përfaqësuesi i Arqipeshkvisë Shkodër-Pult, dr. dom Nike Ukgjini;

Përfaqësues të Ministrisë Kulturore, Drejtoresha e Drejtorisë së Monumenteve të Kulturës Kombëtare, për Qarkun Shkodër e Kukës, zonja Majlida Laçaj;

Përfaqësues të shoqatave të Malësisë së Madh – Nderi i Kombit, z. Sytki Ndreca;

Përfaqësues të Shoqatave të bashkuara "Mirdita", z. Gjon Bruçi;

Përfaqësues të Shoqatës Atdhetare "Postriba", z. Kadri Fikaj;

Përfaqësuesi i Shoqatës Kulturore "Spani", z. Mhill Pali;

Përfaqësues të Këshillit të Qarkut Shkodër, z. Maxhid Cungu;

Përfaqësues të Bashkisë Shkoder, zonja Voltana Ademi;

Të gjithëve ju uroj mirëseardhjen!

Ju faleminderit për respektin ndaj Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar, punimet e konferencës shkencore, me temë "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin", i deklaroj të hapura.

**NDUE SANAJ**

Shkodër, me 14 tetor 2017

**Konferencë shkencore: 100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin****VENDIM****Nr 235 date 06 / 09 / 2017 I KRYESISË SE SHOQATËS ATDHETARE "DUKAGJINI"**

Kryesia Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", sot me datën 6 shtator 2017, pasi diskutoj propozimin e bërë nga Kryetari i Komisionit, Luigj Shyti, për përgatitjen e zhvillimin e Konferencës Shkencore, me temë: "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin",

## VENDOSI:

- Të propozohet Presidentit të Republikës së Shqipërisë, zotit Ilir Meta, për të dekoruar:
  - Piktorin Ndoc Martin Camaj, me titullin "Mjeshtër i Madh", me motivacionin: *"Individualitet i pazëvendësueshëm në fushën e artit. Piktore dhe intelektual me vokacion thellësisht evropian. Me veprimtari të zgjeruar brenda dhe jashtë vendit. Përfaqësues i denjë i avangardës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare"*
  - Piktorin Zef Shoshi, me titullin "Mjeshtër i Madh", me motivacionin: *"Një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm e më të shquar të pikturës moderne shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit të XX. Ndërthures i traditave të ndryshme në fushën e pikturës"*
  - Familja Mjetaj, në fshatin Xhan, të krahinës Pult, e cila përbënte një grup artistik brenda saj, me titullin "Naim Frashri", me motivacionin: *"Familja Mjetaj, si një ndër familjet e nderuara të zonës së Dukagjinit për interpretimin, pasurimin dhe trashëgimin e vlerave në shumë fusha të jetës ku spikasin, atdhetarizmi, arti, etnografia dhe mjekësia"*
  - Familja e Gjoke Pjeter Marku, nga fshati Nenmavriq, të krahinës Shalë, që nxori 9 mësues në dy breza të njëpasnjëshëm, me medaljen "Për merita të veçanta civile", me motivacionin: *"Për kontributin, që kjo familje dha në shërbim të arsimit në Dukagjin. Nën të pjesëtar të kësaj familje, në dy breza, punuan në fushën e arsimit, duke u bërë shëmbull unikal frymëzimi në Dukagjin dhe më gjerë"*
- Për t'u dhënë Medaljoni **"100 VJET ARSIM E KULTURË NË DUKAGJIN"**

Grupit të Parë: Në këtë grup futen, mësuese dhe mësues që kanë pasur punë të parë arsimin, por, natyrisht, arsimit dhe kulturës në të gjitha kohët kanë qenë të lidhura me njëra-tjetrën me motivacion: *"Për devocion e përkushtim të përhershëm në fushën e arsimit dhe ngritjes së nivelit kulturor të bashkësisë dukagjinase"*

1	Age Gjon Arra, Abat
2	Agim T' thorja, Mes
3	Agustin Shuku, Rrënc
4	Aishe Hoxha, Shkodër
5	Ardian Marashi, Tiranë
6	Artan Haxhi, Shkodër
7	At' Justin Rrota, Shkodër, pas vdekjes
8	At' Marjan Prela, Shkodër, pas vdekjes
9	At' Silvestër Hila, Shkodër, pas vdekjes
10	At' Shtjefen Gjeçovi, Shkodër, pas vdekjes
11	Dalina Arra, Palaj
12	Dashamir Jonuz Dini, Shkodër
13	Dede Lulash Mbrapshtia, Gimaj, pas vdekjes
14	Dode Kaçaj, Bajzë, pas vdekjes
15	Drande Mark Kroni
16	Fillip Guraziu, Shkodër
16	Fran Mirash, Çardaku
17	Fran Gjergj Dardha, Abat, pas vdekjes
18	Fran Gjesh Beka, Lekaj, pas vdekjes
19	Frano Luli, pas vdekjes
20	Fran Mark Gjellaj, Theth, pas vdekjes
21	Fran Kole Stani, Rragam, pas vdekjes
22	Gjesh Lulash Ndreshaj, Nenmavriq
23	Gjokë Marashi, Karme-Shkodër
24	Gjon Nosh Arrinaj, Plan
25	Gjovalin Ndoke Kodra, Gjuraj
26	Gjovalin Zef Kolombi, Shkodër
27	Gjyste Martin Shyti, Shkoder
28	Groshe Ndue Ara, Plan
29	Kadri Qerim Fikaj, Shkodër
30	Kadri Ujkaj, M. Madhe
31	Kahreman Ulqini, Shkodër
32	Karlo Larja, Shkodër, pas vdekjes
33	Kin Pllumb Nika, Gimaj
34	Kole Mark Çardaku, Nica - Shalë
35	Kole Zef Funiçi, Gimaj

36	Kole Lin Tonaj, Vuksanaj
37	Kole Rushet Dardha, Lekaj, pas vdekjes
38	Lazer Pjeter Fusha, Nica - Shalë, pas vdekjes
39	Lazer Pjeter Kodra, Ndreaj
40	Lena Kole Bungaja, Nderlysa
41	Lena Mark Fusha, Nica - Shalë
42	Ludovik Dega, Shkodër
43	Luigj Mark Mila, Sumë
44	Luigj Gjergj Shyti, Theth
45	Luk Dede Dreni, Lekaj
46	Luke Dede Mjajaj-Shullani, Lotaj
47	Lulash Kole Marku, Shllak
48	Lulash Ndoc Gilaj, Lotaj
49	Mahir Hoti, Shkodër
50	Marash Miruk Rreshpja, pas vdekjes
51	Marash Zef Marashi, Koman - Temal
52	Marie Kole Gilaj, Lotaj
53	Marie Mhill Musa, Nenmavriq
54	Martin Kole Camaj, Temal, pas vdekjes
55	Martin Dede Çetina, Lekaj
56	Martin Preke Arra, Palaj
57	Mhill Leke Kodra, Ndreaj, pas vdekjes
58	Mhill Pjeter Shkalla, Theth
59	Mhill Qerim Fusha, Abat
60	Mira Lazer Kroni, Palaj-Shosh
61	Mirash Mark Binoshi, Lotaj, pas vdekjes
62	Mirash Zef Ndreaj, Vuksanaj
63	Muhamet Abdyl Shala, Shkodër
64	Ndoc Grime Grimaj, Lotaj
65	Ndoc Marash Odri, Xhan
66	Ndoc Zef Prenushi, Shllak
67	Ndoc Mhill Xhuri, Lotaj, pas vdekjes
68	Ndue Dede Leka, Nenmavriq
69	Ndue Gjoke Bregu, Breglumi, pas vdekjes
70	Ndue Lulash Shytani, Nenmavriq
71	Ndue Gjesh Ndreaj, Vuksanaj, pas vdekjes
72	Ndue Pal Vata, Pecaj

73	Ndue Qerim Quku, Abat
74	Ndue Martin Stragu, Plan
75	Ndue Çuni, Plan, pas vdekjes
76	Nikoll Ndoc Ndreshaj, Nenmavriq
77	Nikoll Pal Bala, Shllak
78	Nike Gjon Germusha, Toplanë
79	Pal Mhill Bregu, Lotaj
80	Pal Nike Rupa, Theth
81	Pal Vate Kroni, Gimaj
82	Pashka Mark Shytani, Nenmavriq
83	Pashko Ndue Biga, Gimaj
84	Pashko Ndue Camaj, Gimaj
85	Pashko Zef Ara, Plan
86	Paulin Pero, Shkodër
87	Pjeter Dode Delija, Lekaj
88	Pjeter Gjon Selimi, Kir, pas vdekjes
89	Pjeter Kole Dreni, Abat, pas vdekjes
90	Pjeter Smakaj, Koplík
91	Preke Nike Vuksani, Ndreaj, pas vdekjes
92	Preke Sokol Sokoli, Lekaj, pas vdekjes
93	Prele Dede Bregu, Breglumi, pas vdekjes
94	Prele Grim Grimaj, Lotaj
95	Prele Mark Milani, Pepsumaj
96	Prele Tome Shytani, Nenmavriq
97	Prenda Pjeter Lekçaj, Lotoj, pas vdekjes
98	Prenda Lulash Çardaku, Theth
99	Romeo Gurakuqi, Shkodër
100	Ruzhdi Poda, Oblik
101	Sebiha Koplíku, Shkodër
102	Syka Mark Çarku, Theth
103	Shkurte Rushet Ara, Palaj
104	Shkurte Like Grimaj, Shkodër
105	Shpëtim Lame, Shkodër
106	Tasim Melloja, Shkodër
107	Tereza Prek Brigja, Kir
108	Tome Lulash Bungaja, Ndërlýsë
109	Tule Pal Ahi, Toplane
110	Tone Pushimaj, Abat
111	Tush Dede Shqau, Shllak
112	Tusha Shytani, Nenmavriq
113	Vat Gjon Demaj, Sume
114	Vitore Kole Kodra, Ndreaj
115	Vjollca Kaja, Shkodër
116	Zamir Tafilica, Shkodër
117	Zef Deda, Shkodër, pas vdekjes
118	Zef Dede Livadhi, Breglumi
119	Zef Pjeter Fusha, Breglumi
120	Zef Ndue Bari, Tirane
121	Zef Nosh Marashi, Shllak
122	Zef Mirash Toka, Ndreaj
123	Zef Nika, Shllak

Grupit të Dytë: Në këtë grup futen, ata që janë marrë me folklorin, këngën dhe vallen, me motivacion: "Njohës dhe promovues i vlerave më të spikatura të folklorit dhe kulturës tradicionale dukagjinase; kontribuues në ruajtjen dhe përcjelljen brezave kulturën tradicionale të folklorit popullor dukagjinase".

1	Agustin Pllumbaj, Shllak
2	Agustin Prek Preka, Gjuraj
3	Aldo Nika, Shkodër
4	Dede Gjon Shtëpia, Xhan
5	Familja Zef Shullani, Lotaj
6	File Lulash Ara, Shelqet
7	File Mark Biga, Gimaj
8	Fran Ndok Kodra, Gjuraj

9	Fran Gjeloš Piniqi, Abat
10	Gezim Zef Suti, Toplane
11	Gjergj Mark Guri, Nicaj-Shosh, pas vdekjes
12	Gjergj Nike Çuni, Theth, pas vdekjes
13	Gjergj Pllumb Gjellaj, Theth, pas vdekjes
14	Gjergj Pllumb Lisi, Plan
15	Gjeto Gjergj Dreni, Lekaj
16	Gjovalin Pal Prioni, Abat
17	Gjovalin Shan Lami, Shosh
18	Kole Bale Stalaj, Gimaj
19	Kole Dede Pepniku, Gimaj, pas vdekjes
20	Kole Dem Bala, Gimaj, pas vdekjes
21	Kole Gjon Stalaj Gimaj, pas vdekjes
22	Kole Prele Martini, Nicaj - Shalë
23	Kujtim Kole Funiçi, Gimaj
24	Lazer Pal Bregu, Nicaj - Shalë
25	Leke Ndue Plaku, Plan, pas vdekjes
26	Lulash Mark Plavra, Plan
27	Marash Ndou Dreni, Lekaj, pas vdekjes
28	Marie Kole Sheji, Theth
29	Marie Gjergj Vocaj, Lezhe
30	Mark Vata, Dushman
31	Martin Pjeter Pisha, Theth
32	Mhill Çun Gjonaj, Nicaj - Shalë
33	Mirash Ndou, Shosh, pas vdekjes
34	Miter Gjergj Ndreshaj, Nenmavriq
35	Ndoc Gjon Ndreshaj, Nenmavriq, pas vdekjes
36	Ndoke Gjeloš Leka, Gjuraj
37	Nikolle Pal Gropcyra, Lekaj, pas vdekjes
38	Nike Fran Çarku, Theth
39	Pjeter Tome Shytani, Nenmavriq
40	Pellumb Mark Tefa, Gjuraj, pas vdekjes
41	Pellumb Pjeter Vrinca, Plan
42	Roza Mhill Pjetri, Nenmavriq
43	Vate Sokol Basha, Lekaj pas vdekjes
44	Violeta Kole, Verrishta
45	Violeta Ndoc Shqau, Shllak
46	Zef Martin Prioni, Shosh, Librashitës
47	Zoje Kole Kola, Nenmavriq, pas vdekjes
48	Zoje Mustafa Guri, Nicaj - Shosh, pas vdekjes

Grupi i tretë: Në këtë grup të përfshihen ata që janë marrë me artizanatin popullor të veshjeve, gjendjeve të drurit e të gurit dhe përgatitjen e veglave muzikore popullore, me motivacion: "Trashëgues duartartë e publikues duke dhënë një kontribut të rëndësishëm për të njohur, ruajtur dhe përhapur nëpërmes punimeve artizanale të dorës, kulturën materiale etnografike popullore të zonës së Dukagjinit".

1	File Ndue Strugaçi, Nderlyasaj
2	Fran Dede Shytani, Lotaj
3	Kujtim Mirash Çemeli, Gimaj
4	Zef Lulash Sokoli, Lotaj, pas vdekjes

Grupi i katërt: Në këtë grup të përfshihen ata që janë marrë me fotografimin, projektimin e filmit dhe pikturën, me motivacion: "Për kontributin që kanë dhënë në regjistrimin dhe projektimin nëpërmes artit pamor e ekranit, të vlerave njerëzore, natyrore e historike të veçanta të zonës së Dukagjinit".

1	Fran Zef Preka, Lekaj
2	Mhill Cak Vata, Rragam
3	Pjerin Sheldia Shkodër, Piktur
4	Zef Sokol Muri, Nicaj - Shosh

Grupi i pestë: Në këtë grup përfshihen ata që kanë hulumtuar, studiuar e botuar libra, me motivacion: "Për sakrificë e vetëdije intelektuale në fushën e krijimeve, studimeve dhe botimeve të eposit shumëdimensional dukagjinase".

1	Gazeta Dukagjini, Shkodër
2	Lazer Preka, Shllak
3	Lazer Pal Stani, Gjuraj
4	Ledia Aleks Dushi, Xhan
5	Luigj Zef Temali, Temal
6	Luigj Nikoll Martini, Shkodër
7	Lulash Bal Brigja, Kir
8	Marash Kole Kola, Lotaj
9	Mhill Dede Pali, Gjuraj
10	Mirash Ndue Mici, Palaj - Shosh, pas vdekjes
11	Ndoc Zeke Selimi, Koman
12	Ndrek Dede Guri, Brashte
13	Ndue Kole Cukeli, Abat, pas vdekjes
14	Ndoc Kole Bjeshka, Nderlysaj
15	Ndue Dode Sanaj, Gjuaj
16	Tone Zef Deda, Temal
17	Voc Dede Mjeteaj, Xhan
18	Zef Preke Gjeta, Tirane

Grupi i gjashtë: Në këtë grup futen ata persona që kanë kontribuar duke dhënë – falur tokë për ndërtimin e shkollës, me motivacion: "Për kontributin e dhënë, duke dhuruar tokë për ndërtimin e shkollës në fshatin Theth, në vitin 1938"

1	Mark Hysen Gurra, Theth, pas vdekjes
2	Preke Prendash Harusha, Theth, pas vdekjes

Grupi i shtatë: Në këtë grup futen ata që janë dalluar në veprimtaritë e shoqatës, me motivacioni: "Për kontributin e dhënë dhe përgjegjësinë e treguar në organizimin dhe realizimin e përhershëm në të gjitha veprimtaritë e shoqatës Atdhetare "Dukagjini"

1	Aleks Fran Dushi, Xhan
---	------------------------

3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Seksioni për Marrëdhënie Publike.  
4- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

NDUE SANAJ, KRYETARI


# Shkrimtari, publicisti e veprimtari Zef Pergega, në Malësi të Madhe

Me datën 18 tetor 2017, në mjedisin e Bar-Restorant "Keshjtjella Xhafaj", u organizua nga z. Kadri Ujka, Kryetari i Shoqatës së shkrimtarëve të Malësisë së Madhe, paraqitja e dy librave, me titull "Malësorët" dhe "Kontacioni i Premtuar", të autorit Zef Pergega, mirditor, me banim në Michigan.

Në këtë ceremoni mora pjesë me Prele Milanin. Pati pjesëmarrës personalitete të letrave nga Malësia e Madhe, nga Tuzi, në mes tyre poeti Dak Keqja, humoristi Qazim Çela, Dimitrov Popoviç, Shtjefen Ivezaj e të tjerë, Mori pjesë poetja Mimoza Rexhvelaj, poetja Ferida Ramadani, studiuesja Rita Shkurtaç, poeti Ndue Gjeka, shkrimtari e studiuesi Profesor Lualsh Palushaj, dhe në mes tyre edhe Mjeshtri i Madh Fadil Kraja.

Ishte një ceremoni e mirëorganizuar. Dhanë opinionin e tyre shumë nga pjesëmarrësit, duke lartësuar vlerat e punës studiuese të zotit Zef dhe për vlerat e Malësisë së Madhe dhe banorëve të saj në shekuj. Në fund, autori, Zefi shtroi një drekë të mirë, me të gjitha të mirat ... Me siguri që ka, por atë e shtroi jo pasja, po zemra e bujrrare e tij. Të lumtë Zef Përgega! Paç e dhençë!

Redaksia



# TE KTHEJMESYTENGA DUKAGJINI

- NË MBYDHJE TË KONFERENCËS SHKENCORE "100 VJET ARSIM DHE KULTURË NË DUKAGJIN" -

Konferenca shkencore "100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin" u mbydh m3e sukses të plotë.

Ishte një përpjekje me shumë rëndësi, me shumë mund dhe përpjekje, me takime, biseda, pyetje, përgjigje, kërkime ne arkiva, konsultime me studime, me intelektual të mirëfillshite, kujtime të mësuesve që punun me përkushtim shumë të madh, që shumë prej tyre, erdhën në moshë të re dhe u kthyen familjarë dhe prindër me fëmijë.

Gjatë këtyre viteve, duke përballuar vështirësi të shumta, të gjithfarshme, punuan mësuesit në Dukagjin, djem e vajza, burra e gra, në kohë të mira dhe jo të mirë, udhëtuan duke kaluar qafa malesh deri 2000 m, duke udhëtuar nëpër rrugë të vështira, pse jo edhe të rrezikshme, për të ardhur në punë, për tu shërbyer vocrrakëve malësore, por edhe duke sjellur kulturë me shembullin dhe mërrëdhëniet me banorët. Aspak nuk e teproj kur them se mësuesit që punuan në Dukagjin do të kujtohen për të mirë shumë gjatë. U krijuan marrëdhënie e lidhje të reja, por shumë të mira dhe të qëndrueshme. Puna dhe shoqëria e krijuar nëpërmes punës midis mësuesve vendas-dukagjinas dhe mësuesve që vinin nga zona jashtë Dukagjinit ndihmuan njëri tjetrit, qenë përkrah njëri tjetrit, punuan dhe arritën bashkë fitore.

Me shumë respekt, përkulemi përpara punës të të gjithë mësuesve që punuan në Dukagjin, por edhe të gjithë atyre që punuan dhe punojnë për ruajtjen e kulturës popullore folklorike, artizanatit, botuesve të librave, dhe veprimtarëve në këtë drejtim.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" që në nismën për të realizuar këtë konferencë, përcaktoj objektiva të sakta dhe të plota, natyrisht brenda mundësive të saj modestë, por me ndihmën dhe përkrahjen morale dhe materiale të dukagjinasve. U realizua një punë e kujdesshme organizative në kryesinë e shoqatës e grupet e punës pran saj, dhe u ndoqën hap pas hapi etapat e programit të punës, të cilat u realizuan mjaftë mirë.

E ndjej për detyrë të falnderoj gjithë grupin që pranuan dhe morën përsipër kumtesa, të cilët e vlerësuan, punuan, kërkuan dhe realizuan kumtime serioze dhe me vlera. Faleminderit për punën tuaj serioze dhe cilësore në kumtimet tuaja që bëtë të mundur realizimin me sukses të kësaj Konference, i shtuat vlera arsimi në Dukagjin, i shtuat vlerat kulturës, i shtuat vlerat krahinës tonë emërmadhe, zonjat dhe zotrinjtë Ndue Sanaj, Prelë Shytani, Tereze Brigja, Zef Fusha, Fran Kodra, Gjyste Shyti, Zamir Taflica.

Kësaj Konference ja rritën vlerat edhe shumë mësues dhe ish mësues në vite, që me kujtimet e tyre shumë të vlefshme dhe serioze, të cilët sollën shumë të dhëna dhe momente pikante të punës dhe jetës së tyre në krahinën e Dukagjinit, por edhe piktor që kanë përjetësuar në telajot e tyre Dukagjinin, atyre që me

foto apo nëpërmes medias elektronike kanë popullarizuar vlerat dukagjinase, etj. Faleminderit për korrektësinë dhe bashkëpunimin shumë dashamirës zotërinjë dhe zonja: Profesor Gjovalin Kolombi, Muhamet Shala, Ruzhdi Poda, Sebiha Kopliku, Ndue Vata, Ndoc Odri, Kolë Funiçi, Muhamet Ganjolla, Paulin Pero, Kadri Ujka, Pjerin Sheldia, Ndoc Grimaj, Zef Bari. Një ndihmesë mjaftë të rëndësishme dhanë edhe zotërinjtë dhe zonjat, Prof. Gjovalin Kolombi, Zef Pjetër Deda, Aishe Hoxha, Nikollë Gjokë

por nuk jemi ndalur. Ne nuk kemi arritur më të mirën e mundshme, gjatë punës për përgatitjen dhe zhvillimin e kësaj konference. Kemi bërë të mundur që të vendosim një themel, po të mund ta quajmë kështu, pasi nuk e kishim një të tillë, mbi të cilin mund të punojnë studiues dhe intelektual, dhe ta ngrenë akoma më lartë krahinën e Dukagjinit nëpërmes vlerave të tij. Ne u përpoqëm që të mund të ndriçojmë me sa mundësi që kishim, atë rrugë njëshekullore që kaloj shkolla dhe

rëndësishme këtë konferencë, edhe pse kemi mendimin se nuk është shterruese në këtë drejtim, por koha dhe studiuesit besojmë se do të jenë në drejtimin e duhur për të thelluar e pasuruar këto studime në të ardhmen.

Duhet të dalësh në dritë, në rojë, të ngjitesh përpjetë, që të shikohesh. U bë e domosdoshme që të ishte një grup, një shoqëri, apo një shoqatë, për tu dalur përballë disa të metave të pjestarëve të ndryshëm të komunitetit tonë, por edhe me mosarsyen e arsyes për bërjen vend në sofrën e kohës, në punë e përkrahje, në mbështetje në jetën shoqërore-ekonomike të vendit. Shoqata "Atdhetare Dukagjini" i kushtoj kujdes të madhe problemeve të këtij komuniteti si në vendlindje, por edhe në të gjitha ngulimet e reja pas lëvizjeve të vullshme të popullsisë.

Unë, me shumë respekt dua të falnderoj kryesinë e shoqatës "Atdhetare Dukagjini", për vlerësimin e kesaj nisme, këtij aksioni mjaftë të vlefshëm për sot dhe për kujtesën ndër breza, që punoj me shumë përkushtim e vendosmëri për realizimin me sukses të kësaj veprimtarie. Na u gjetën pranë edhe shumë të tjerë, dukagjinas dhe jo dukagjinas por dashamirë dhe miq të përhershëm të Dukagjinit. Në punën tonë u ndeshëm edhe me ndonjë person që bënte "pse" më shumë se sa prodhim ideshë, apo ndonjë mendim i vetmuar nihilist, por na erdhën shumë më shumë mendime që na ndihmuan, në mbështetjen, na mobilizuan. Faleminderit të gjithëve, madje edhe atyre që nuk patën besim në fillimet tona, sepse na mobilizuan edhe më shumë.

Dua të falnderoj të gjithë kumtuesit për punën e tyre serioze, atyre që me kujtimet e tyre i dhanë freski, dinamikë, aktualitet dhe bukuri Konferencës tonë. Jo radhë kemi pasur edhe debate, në kryesi, në grupin e punës, natyrisht për të mirë të punës, ishim miq por edhe pas debateve dhe sot mbetëm dhe mbetemi miq të mirë midis njëri tjetrit, sepse nuk kishim asgjë personale.

Nuk mund të rri pa ju bërë thirrje, me gjithë zemër, të gjitha organeve shtetërore dhe shoqërore, institucioneve qendrore dhe vendore, organeve të specializuara, për të kthyer sytë nga Dukagjini për vetë vlerat e tij shoqërore, historike, natyrore, turistike e kulturore, sepse ky vend ka shumë mundësi zhvillimi, të bëhet e mundur që të mblidhen dhe të konservohen vlerat gjuhësore, arkeologjike dhe kultura materialet popullore, historia etj. Është koha që të veprohet, që të mos themi më vonë "na ishte një herë", apo "ah, na ikën vlerat".

Faleminderit të gjithëve për praninë dhe kohën që i kushtuan kësaj konference.

Luigj SHYTI  
Shkodër, më 14 tetor 2017



Bregu, Tasim Mlloja, Syka Çarku, Shpetim Lame, Ruzhdi Poda, Pjerin Sheldia, Ndoc Grimaj, Dedë Toka, Sebiha Kopliku, Antonjeta Bakalli, Ndoc Prendushi, Fran Lisi, Kolë Funiçi, Zef Toka, Gjok Marashi, Martin Çetina, Prelë Shytani, Kolë Çardaku, Pashko Biga, Mirash Ndreza, Age Qerim Gila, Pashko Ara, Ndue Lulash Bobnaj e Lazer Dardha, Nikë Germusha, Marash Marashi, Gjokë Marashi, Ndoc Odri, Pashko Ara dhe Vasel Popaj, që me të dhëna dhe foto që na sollën, të cilat patën rastin që të mund ti shikoni në ekspozitën që sado jo e plotë, na çoi në ato kohë interesante për sot, por më shumë për brezat që vinë, por dhe pasuruan punimet për Konferencën.

Me këtë rast i kërkujmë Ministrisë së Kulturës përkthimin dhe vënien në qarkullim sa më parë të jenë e mundur të librit, për brendinë e të cilit foli zoti Zamir Taflica.

Ne jemi shoqatë jo fitim prurëse, kemi pak mundësi, por jemi guximtarë, kemi ecur përpara, pa çka se kemi takuar edhe në ndonjë gjëmb rrugës, na ka shpuar,

shkollimi në Dukagjin, kultura dhe zhvillimi i saj. U përpoqëm që të evidentojmë punën e atyre, që po them pa frikë se janë qindra edukator gjatë kësaj periudhe, janë shumë punonjës kulture dhe amator të artit e kulturës, artizan duarartë, veprimtar të përhershëm. Është fakt i pamohueshëm që të gjithë janë me shumë vlera, të cilat duhet ruajtur dhe transmetuar brezave.

Në qoftë se është ngritur sadopak një shkollë dhe shkollim në Dukagjin, gurin e parë ne themelin e saj e kanë vënë klerikët katolik, famulltarët e fshatrave, që kanë punuar në fshatra e Dukagjinit, të cilët u bënë nismëtarët për shkollimin e "zogjëve të malsisë", siç shpreheshin ata, dhe që gjetën mbështetje te shteti i kohës për një farë kohë, sado që ishte me shumë halle për vete. Nderim dhe respekt për priftërinjtë që u bënë fillestarët e arsimit në Dukagjin, por edhe për të gjithë ata që me përkushtim dhe ndërgjegje të lartë u vunë në shërbim të shkollimit të malësorëve dukagjinas gjatë gjithë kohës. Ne e vlerësojmë si mjaftë të

# NË TAKIMI PAHARRUAR

**MBLIDHET NË GJIMNAZIN "28 NËNTORI",  
NË SHKODËR PAS 50 VITEVE "MATURA '67"**

Gjimnazi "28 Nëntori" në qytetin e Shkodrës daton hapjen e tij në vitin e largët, 1922. Pas një periudhe shumë të errët historike të një pushtimi të gjatë pesë shekullor, pas përpjekjeve të mëdha të rilindësve dhe të njerëzve të tjerë të shquar përhapjen aty-këtu në Shqipëri të shkollave të para shqipe, pikërisht pas shpalljes së pavarësisë u deshën pak kohë që arsimit shqiptar të bënte hapet e parë për krijimin e një shkolle shqipe më të avancuar e më të konsoliduar. Kështu pas shumë përpjekjeve erdhi viti 1922 kur hapet për herë të parë një shkollë e mirëfilltë thellësisht kombëtare që u emërtua Gjimnaz.

Kjo shkollë që, që atëherë ishte në nivelin e një shkolle të mesme të përgjithshme u hap në qytetin e Shkodrës, në atë qytet ku askund më shumë se atje nuk do të gjente të gjitha kërkesat përhapjen e një shkolle të tillë, duke u lidhur me traditën social-kulturore të qytetit, me etjen e brezit rinor përdije, por edhe me nivelin intelektual e profesional të grupit do të ishte grupi i mësuesëve të këtij gjimnazi, që nga krijimi e në vijim.

Gjimnazi i Shkodrës, me këtë emërtim zyrtar u bë shpejt një Gjimnaz Kombëtar, sepse në bankat e tij u ulën nxënës nga të gjitha krahinat dhe qytetet e Shqipërisë dhe Kosovës.

Për një fillim të mbarë drejtimin e gjimnazit e mori pikërisht vetë ministri i arsimit të asaj kohez, Mirash Ivanaj, intelektual dhe patriot i shquar që ka lënë gjurmë në historinë e arsimit shqiptar, për të vazhduar më pas me një figurë tjetër të nderuar, z. Xhevat Korça, që në historikun e gjimnazit është edhe drejtori i parë i tij.

Kështu mori rrugë kjo shkollë që në gjithë historinë e saj ka qenë dhe është qendër e madhe e edukimit arsimor e qytetar të shumë e shumë brezave, por dhe një vatër e dijes, patriotizmit dhe shqiptarizms.

Sivjet janë mbushur 95 vjet, që nga hapja e Gjimnazit të Shkodrës, sot Gjimnazi "28 Nëntori".

E bëmë një hapje pak të gjatë historike, sepse asnjë ngjarje që lidhet me këtë shkollë nuk mund të shpjegohet e nënkuptohet pa të.

Unë në këtë shkrim do të ndalem në një nga këto vende që lidhet me maturen 1967, pra me nxënësit që kanë mbaruar Gjimnazin e Shkodrës në këtë vit.

Ata janë gjallë dhe aktivë, pavarësisht se jeta e ka shkëputur ndonjë nga klasa e tyre e dikurshme. Ata janë gjallë dhe aktivë, sepse si shumë breza të tjerë maturantësh që kanë dalë nga bankat e kësaj shkolle, në jetën e tyre kanë dhënë një kontribut të shquar në sfera dhe fronte të ndryshme të jetës sociale dhe ekonomike.

Unë isha atje mes tyre dhe profesorëve të tyre, i ftuar nga prof. FadilKraja "Mjeshtër i Madh", ish mësues i këtij gjimnazi. I shihja të ulur në bankat e

klasës, ashtu si dikur dhe më dukeshin përsëri të ri, siç i thonë fjalës gjimnazistë. Flokët e bardhë, rrudhat dhe ndryshimet e moshës i sfidonte dashuria dhe nostalgjia për atë kohë të artë rinore. Nga këta ish nxënës kanë dalë mjekë dhe peda-



gogë, inxhinierë dhe shkrimtarë, studiues e historianë, por dhe shumë mjeshtra e specialist të kualifikuar, që kanë bërë emër në profesionet e tyre, si brenda dhe



vështronin në bankat përballë nxënësit e tyre ashtu si dikur.

Pas apelit, të cilin e lexoi një nga ish nxënëset, ku të gjithë u përgjigjën "këtu" si dikur, u mbajt një minutë heshtje për at bashkënxënës dhe mësues që nuk ishin në mes tyre.

Të gjithë "nxënësit" u ulën në bankat e tyre dhe nëndrejtimin e prof. FadilKrajës u zhvillua një orë mësimi, një orë jo si gjithë të tjerat, që këta nxënës kanë përjetuar në rininë e tyre, por një orë mësimi, që do të mbetet në jetën e tyre më e bukura, më e paharruara dhe më origjinale.

Edhe pse pak të vjetër në moshë, nxënësit ishin përsëri çapkënë e rinorë, sepse si i thonë në Shkodër, nuk kishin harruar "dreqnitë".

Në këtë linjë ishte edhe mësuesi i tyre i madhi FadilKraja, që humorin e tij nuk e ka manifestuar vetëm në marrëdhëniet me nxënësi e tij, por e ka përjetuar edhe në komeditë dhedramat e tij, të vëna në skenë me shumë sukses.

Atmosfera ishte e jashtëzakonshme, sa mund të thuash se kjo klasë atë ditë në ambientet e Gjimnazit ishte klasa që bënte zhurmë më shumë. Asnjë ceremoni zyrtare, asnjë pompozitet, por një takim që këta maturantë të 50 viteve më parë do ta ruajnë në kujtesën e tyre si një ngjarje të paharruar.

E quaj për detyrë që në këtë shkrim t'i dominoj të gjithë këta djem e vajza maturantë, që pas 50 viteve u mblodhën në klasën e tyre, pa iu përmendur aftësitë dhe meritat, që kanë fituar në jetë, sepse të gjithë këta ishin pjesë e kësaj klase, e këtij Gjimnazi që i nxori nga bankat e veta të barabartë dhe të aftë për të çarë në rrugën e jetës sipas dëshirave dhe pasioneve të tyre.

Nxënësit e maturës '67 që u ulën pas 50 viteve në bankat e tyre sipas apelit: Agrikol Gjermani, Agim Nako-mungesë, Agron Parruca, Ali Lezha, Alida Prendushi-mungesë, Anton Leka, Eduard Fishta, Fatbardh Sokoli, Gjergj Morina, Hafete Kazazi, Irena Jaku, Irena Kiri, Jozef Tedescini, Jozefina Nikaj, Gjyzepeina Kodheli, Lumnije Caka, Luigj Derragjati - nuk jeton, Pjerin Kaftalli, Pranvera Metushi, Madalena Deda, Mustaf Dergjini, Muhamet Trepçi, Mentor Kopliku - mungesë, Myrvete Picoka-mungesë, Shpresa Ahmetaga, Spartak Koxha, Syrri Dizdari, Tomazin Doda, Violeta Xhani-mungesë, Xhavit Ujkani dhe Xhelal Zaganjori - nuk jetojnë, Zyliha Skura.

Në fund të kësaj veprimtarie të mrekullueshëm u shtrua një koktejl, që kaloi në një atmosferë të gëzueshme, ku secili prej tyre kishte çfarë të sillte ngakujtimet e veta.

**Korrespondenti i gazetës, tetor 2017**

# ROBERT ELSIE VARROSET NE THETH

Më 18 tetor 2017, Dr. Robert Elsie varrosset ne Theth sipas dëshirës së tij. Varrimi u bë me të gjitha nderet tradicionale te krahinës. Trupi i tij u vendos në banesën e fundit në varret e fshatit Theth. Sipas traditës katolike, arkivoli me trupin e tij beri një qëndrim në kishën e fshatit, ku u thanë uratët e përshpirtjes, pastaj i bartun në duar, në shenjë respekti, arkivoli me trupin e tij bëri udhëtimin e fundit për në banesën e përjetshme. Mbi varrin e tij u vendosën kiurora dhe shumë tufa me lule natyrale nga shumë banorë. Mbi varrin e Dr. Robert Elsie u vendosën edhe kurorat e Presidentit të Republikës së Shqipërisë Ilir Meta, kurorë e Kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama, kurorë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe shumë kurora të tjera. Kurorën në emër të banorëve të Thethit e vendosi kryetari i këtij fshati Marash Rrgadha. Për jetën dhe veprën e Dr Robert Elsie foli Dr. Mark Palnikaj. Arkivolin me trupin e tij e shoqërun nga Tirana për në Theth edhe personalitete si Prof. Shaban Sinani, Prof. Romeo Gurakuqi, etj. Kishin ardhur enkas nga Prishtina për këtë ceremoni Neriman Kamberi pedagogje në Universitetin e Prishtinës, Leman Kamberi përkthyes, etj. Pas varrimit, siç është tradita e fshatit, u shtrua një drekë e përshpirtshme.

\*\*\*

Robert Elsie është me origjinë gjermane. Ai u lind më 29 qershor 1950 në Vankuvër të Kanadasë. Ndoqi Universitetin e Kolumbisë Britanike ku mbaroi studimet e filologjisë klasike dhe të gjuhësisë më 1972. Po në atë vit, erdhi në Europë me një bursë studimesh.

Vazhdoi studimet e larta në Universitetin e Lirë të Berlinit Perëndimor, në Shkollën Praktike të Studimeve të Larta në Paris, në Institutin e Dublinit për Studime të Larta në Irlandë, dhe në Universitetin e Bonit ku mbrojt doktoraturën më 1978. Që nga 1978 pati mundësi të vizitojë Shqipërinë disa herë në kuadrin e "takimeve shkencore" midis Institutit të Gjuhësisë së Universitetit të Bonit dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Gjithashtu mori pjesë disa vite me radhë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Kosovë. Pas studimeve universitare ai punoi për Ministrinë e Punëve të Jashtme gjermane në Bon dhe nga 2002 deri 2013 për Tribunalin e Hagës. Është anëtar i Shoqatës së Evropës Juglindore, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si dhe anëtar nderi i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. U nda nga jeta më 2 tetor 2017, duke lënë amanet që të prehej në Shqipëri.

Dr. Robert Elsie është nderuar me Medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit Kosovë nga Presidenti i Kosovës, si dhe me medaljen e mirënjohjes nga Presidenti i Shqipërisë Bujar Nishani. "Dr. Elsie mbetet pa dyshim përhapësi më i madh i kulturës shqiptare në botë", ka thënë kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Hivzi Islami.

Robert Elsie guxonte si një intelektual i lartë, e mbrojtë Shqipërinë në botë, e bashkoi në veprën e Tij me Kosovën dhe Çamërinë, i dha zë Shqipërisë, të flasë anglishten e tij. Robert Elsie ishte pelegrin i tempujve të Shqipërisë, shtegtar i maleve tona, adhures i bregdetit, qytetar i Tiranës, mik i mrekullueshëm me ne. Është nder që Shqipëria ta shpallë bir të vetin, shkruan Visar ZHITI.



Varri i Dr. Elsie do të jenë një vend pelegrinazhi, në nderë dhe respekt të tij për punën gjingande që ka bërë si albanologu më i madhe bashkohor e si publikues i Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Përgatiti Luigj Shyti  
Theth, 18.10.2017

## N'THETHIN TËND ROBERT

Thethi, ky Fron i Zotit dhe Djep i Valbonës,  
den baba den, Plisbardhësi n'Qjell,  
ashtu si Tomorri, Hyjnor i Dodonës,  
a patët një më t' Madh, që ndriti si Diell?!  
Porosinë e Shpirtit e lënë mëndjendriturit,  
e dijn çka duan edhe në përjetësi,  
e dijn sigurisht se ku do t'prehin shpirtin,  
dhe ku e ku më mirë se n'tonën Shqipni?!  
E Thethi i lashtë, Selia e Batonit,  
ku ngjitej n'naltësi që t'i lutet Diellit,  
me nderë e besë bashk, sot i ngriten Fronin,  
Djalit të birsuem, nën kaltërsi t'Qjellit!  
Aty dikur nderuan dhe Mis Edith Durhamin,  
atë Zonjën Fisnike nga Derë e Parë Angleze,  
aty sot lartësuan, Robert Els' Albanin,  
n'Madhështinë e Tij Kreshnike, mirësi Kanadeze!  
Asht pasunue sot Thethi, me Monument Vigani,  
ia ruan ato eshtna, në prehje të qetë,  
mbinë bari e bjen gjithi, o Robert Albani,  
do t'ndritë si eshka, Drita që e ndeze vetë!

Poezi nga Mentor Thaçi



## PREL MILANI, PËRSERI NË BIBLIOTEKËN "MARIN BARLETI"

Me datën 8 tetor 2017, ditë e diele, mjedis i promovimit të librave, në bibliotekën "Marin Barleti", ishte plotë e për plotë me shkrimtar, poet, studiues e dashamirë të artit të shkruar, anëtar të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", miq e mike të poetit, studiuesit e publicistit Prele Milani, si dhe familjar të tij.

Drejtori i Bibliotekës "Marin Barleti", z. Gjovalin Çuni, Shoqata e shkrimtareve Shkodër dhe Shoqata Atdhetare "Dukagjini", te tre së bashku organizuan ceremoninë e promovimit të dy librave të Preles, një vëllim me poezi satirike, me titull "Burrat vdiqën, të na rrojnë gratë" dhe libri, me titull "Zoja e Berishës".

Ceremoninë e hapi zot Gjovalin Çuni, i cili pasi i beri një ekspozitë të gjere të vepërimitarisë krijuese të Preles, ja dha fjalën Kryetarit të Shoqatës së shkrimtareve të Shkodrës, poetit Skënder Temali. Pastaj dhanë opinionet e tyre, Ndue Sanaj, Lazer Kodra, Qazim Çela, Kadri Ujkaj, Mimoza Rexhvelaj, Lulash Brigja dhe lexoi pjesë nga dy librat zonjusha Diana Bungu.

Në fund foli dhe autori i librave, Prele Milani, i cili falënderoj pjesëmarrjen, ata që dhanë opinionet e tyre, dhe premtoj se së shpejti do na ftoj në këtë sallë, për të promovuar krijimtari të reja, në veçanti në fushën e satirës.

\*\*\*

Mbas ceremonisë, koha vijoi në katin e pare, me një koktej të veçante, me shume llojshmëri ushqimesh, raki, vere, kokakola, qofte, djathë, rrush, gurabije, pije buta të ndryshme, ashtu siç dine ta përgatis e shtroj vetëm bashkëshortja e Preles, Angelina Milani.

## SHOQATA ATDHEËRE "DUKAGJINI", PËRSERI NË BIBLIOTEKËN "MARIN BARLETI"

**Fjala e zotit Ndue Sanaj me këtë rast**

Të nderuar të pranishëm!

Nuk është hera e pare, që takohemi në mjediset e kësaj biblioteke dhe e në veçanti për krijimtarinë e zotit Prele Milani. Ne, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", për krijues e botues të ndryshëm dukagjinas e jo dukagjinas, në bashkëpunim me Drejtorin e bibliotekës "Marin Barleti", zotin Gjovalin, me shoqatën e shkrimtarëve të Shkodrës, që organizojmë ceremoni promovuese libri në këtë sallë dhe ky i sotmi është i 67-i rast, që bashkohemi dhe zhvillojmë ceremoni të paraqitjes së librave, të paraqitjes së shkrimtarëve dukagjinas, në këtë tempull të dijes, çka ne e ndjejmë veten krenar e të motivuar që të ecim pa u ndalur drejt dijes

së thellë, që të njohim më mirë të kaluarën tonë, të nxjerrim ato vlera që duhet prezantuar në bashkësinë ku jetojmë, në kohën e duhur dhe t'i bashkojmë ato me vlerat më të mira të vendasve. Prandaj, falënderoj zotin Gjovalin, zotin Skënder dhe gjithë shkrimtarët e Shkodrës sonë e më gjerë për këtë afrim të tyre, për këtë bashkëpunim të tyre.

Shkrimtari Irlandez, Oscar Eilde, shkruante: "Askush s'është aq i pasur sa të blejë të kaluarën e tij ...". Prandaj, Prele duke pasur parasysh këtë thënie të këtij shkrimtari të madh, nëpërmjet këtij libri, me titull të veçante "Zoja e Berishës", na thotë, se të kaluarën nuk kemi nevojë ta blejmë, se edhe po të duam, ajo nuk blidhet, por atë e kemi në mes nesh, atje ku të parët tanë mbijetuan dhe një pjesë të saj po e sjellë para jush, po sjellë para lexuesve, në këtë kohë modern, jetën e banorëve të trevave të Malësisë, dhe në veçanti të Dukagjinit. Ajo e kaluar ishte me ato rregulla të kohës së saj, të cilat mbajtën gjallë shpirtin tonë, shpirtin e shqiptarit tonë, e cila nuk ka qenë e lehtë.

Prela na sjellë kohën e kaluar, kohën e disa shekujve të shkuar, se si ata jetoni, se si ata vuanin, se si ata malësor dukagjinas edhe gëzonin. Pra, në qendër të tij është aftësia e malësorit, që jo vetëm me përballuar skamjen, vështirësitë e jetesës, por dhe se si gjeni mundësinë, se si gjenin forcën edhe të organizohen e

i Preles, jo vetëm që atë e ka venë para përgjegjësisë, që të jetë sa më i saktë në mbledhjen e traditave, në këtë rast të gëzimit në festën e fisit dhe mënyrën e festimit të saj, të shprehjeve popullore që përdorshin nga pjesëmarrësit në festë, por është edhe një detyrë që na ngarkon Prela dhe ne, që bëjmë përpjekje të hulumtojmë e të studiojmë të kaluarën, për ta nxjerrë atë nga pusi i thellë, nga pusi ndoshta dhe i harresës, për ta zbuluar atë dhe për ta pasqyruar në kohën tonë, dhe pa tjetër edhe për të nxjerrë mësimet e nevojshme për të ecur më tej drejt dijes, se pa te nuk ka emancipim...

Prela na thotë, se në këto male bujaria ishte një traditë e veçante. Dhe për këtë, në faqen 31, shkruan: "Në male falënderohej Zoti, që po i çonte mikun në shtëpi! Në këto male një gjysmë ore larg dhe kundrejt shtëpisë, me kushtrimin e mikut, i urohej MIRSEARDHJA! Në male dhe vetëm në male tona, çdo shpi, çdo katund, çdo fis mikun e priste me pushkë e bataraq sa ambient ngjasonte me një amfiteatër gjigand në skenën e të cilit interpretohesh në mënyrën spektakolare në një "luftë e çuditshme" bujare, ku dionisaket iliro-arbnore (shqiptare) me madhësinë e krenimit të festës së partanit të tyre, sfidonin dhe linin në harresë athinasit e vjetër në festat e tyre të mëdha të vjeljes së rrushit që baheshin për nder të perëndisë Dioniz ...."



hej me rregull e disiplinë. Ajo ishte ndera kryesore e tërvësës, për mikun tërvësë ishte e shenjtë, dehja ishte turp. Nji njeri i dhanun mbas gotës nuk mund të rreshtohet në radhë me burra ..."

Rakia pihej jo vetëm për me çele kuvend, por dhe për të bërë qeft, e qefti donte këngën. Duke respektuar miqtë dhe për këtë këngën e niste së pari një i shtëpisë dhe zgjidhte këngën që ishte për miqtë... Për këtë, në fq. 44, i zoti i shtëpisë i drejtohej nipit: "Merre gotën dhe uroje këtë miqësi, se tash je ba burrë e duhet me ja nisë edhe një kange" ... Bukur!

Po, gjithashtu i zoti i shtëpisë, për me fut në këngë miqtë, ju drejtohet: "Tung-ja-jeta proba! Mos më rri burrë si me kenë t'u ba shqile, nisja një kange, e ma ndihmo një trame, se të kam zgjedh vëlla gihitit me kokërr në 700 shpi ... dhe probja ja kthen: "Pasha Zotin more probatin me kenë ti në rrezik nuk me dhimbet vetja për ty kurri fije! Unë po ja nisi, por nuk e di si po me del zanin, por mos u mahitni me mue, se kanga nuk asht zanati em"

\*\*\*

Unë nuk dua të zgjatëm më shumë, se ceremonia e paraqitjes së librit nuk është moment analize, por siç thekson shpesh profesor Fadil Kraja, janë për të thënë se sa bukur na ka dale nusja, por dua të ndalem te një moment shumë i rendë, por shumë kuptimplote për kohën, se gjërat duhen parë e analizua në

kohën e tyre ..., kur vrasin djalin e Mark Sadikut, nipit të atdhetarit të madh, Mehmet Shpendit ..., i cili në ato moment thotë: "Për një djalë t'emin se due kreun e tanë një fisi mikëpreme". Ky qëndrim i Mark Sadikut, në kohën e tij, megjithëse ishte në momentin më të vështirë të varrosjes së djalit po të thuash fëmijë, me urtësinë e tij, me burrërinë e tij mbylli gjithçka, ndaloi gjithçka të keqe, që mund të ndodhte më pas.

\*\*\*

Në mbyllje, them se duhet të vijojmë si Prela të hulumtojmë e të paraqesim sot vlerat e të pareve tanë dhe të krenohemi me vlerat

të gëzojnë, duke përdorur ndoshta jo të drejtpërsëdrejti, shprehjen popullore "ta kthejmë dhimbjen në forcë"

Në këtë libër janë pasqyruar shumë tradita e mënyre të organizimit e të bashkimit në gëzime e në hidhërime, por edhe në ngjarje mjaft të rënda, siç është vrasja e djalit të Mark Sadikut, të një burri malësor pa dije shkollore, por me një zgjuarsitë të veçante natyrore dhe të aftë për të mbyllë plagë të vjetra e të reja që mund të hapeshin, për të mos u mbyllur kurrë.

Në parathënie të këtij libri, autori shkruan "Nuk më trembin ligjësitë e natyrës, por frikësohem nëse ia arrij të mbledh diçka të vlerë nga tradita, mbasi gjyshërit tanë kjenë të dënuar nga fati të mos i zbardhin në letër ...", fq. 3. Ky mendim

Më poshtë, në fq. 35 shkruan: "Në male ma e para ndere dhe ma e çmueshmja për mikun asht zemra e hapun dhe fytyra e qeshun e zotit të shpisë ....". Po, një virtutë e i jashtëzakonshëm, se nuk kishte dhe nuk ka kuptim pritja e mikut me vetulla të vërejtura edhe sot në takime në mes miqsh, kështu është ky virtutë.

Në mes të tjerave, të tërheq vëmendjen mënyra e qitjes së rakisë, për të cilën Prela shkruan në fq. 42: "Asnji here nuk ka kenë e preferuar gastarja në tërvësë, gastarja konsiderohej paditëse si për miqtë, si për shpiakun. Asnjëra palë nuk donte me e ditë as sa po pi miku, as sa raki ka ibriku, i cili përfaqësonte të ardhurat, se nuk shterohej kurrë. Rakia pi-

e tyre, që munden të mbijetojnë në ato kushte shumë të vështira, në kushtet e varfërisë ekstreme. Por, gjithashtu duhet të bëjmë përpjekje që të mos folklorizohemi e të mos mbesim peng e së kaluarës, se pengëzimi i saj do na lerë prapa në emancipimin shoqëror të bashkësisë sonë e të gjitha bashkësive shqiptare.

\*\*\*

Prele Milani, na bashkosh përsëri, me krijime të reja dhe ju faleminderit për punën që bën.

Të lumtë!

Faleminderit zoti Gjovalin e Skënder për bashkëpunimin dhe krijimin e kushteve për tu prezantuar krijuesit tanë.

**Ndue Sanaj, 8 tetor 2017**

# Dita e "Lumturimit" të Nënë Terezës

Plot katërbëdhjetë vite më parë (19 tetor 2003), Nënë Tereza u shpall e "Lumturuar" nga Papa Gjon Pali II. Në maj 2011 është mbajtur ceremonia e shenjtë e lumturimit të Nënë Terezës, në Bazilikën e Shën Pjetrit, në Vatikan.

Ajo shihet si simbol i ndihmës dhe respektit për "më të varfërit e të varfërve", të cilëve ia kushtoi gjithë jetën.

Në 4 Shtator 2016, Nënë Tereza u shpall Shën Tereza e Kalkutës, në një ceremoni madhështore fetare në sheshin "Shën Pjetri" në Vatikan.

Ceremonia u drejtua nga Papa Françesku, i cili bëri edhe shpalljen e shenjtërimit para dhjetëra mijë pelegrinëve që mbushën sheshin qendror të selisë së shenjtë.

Ikona e madhe shqiptare, e cila i dhe Shqipërisë njohje ndërkombëtar në mbare botën.

Veprimtaria e saj e bamirësisë bëri, që Nënë Tereza të mos jetë Nëna vetëm e shqiptarve, por një Nënë e përbotshme, e cila me veprimtarinë e saj të bamirësisë bëri, që Shqipëria të lartësohet në opinionin Botëorë!

Bill Klinton nder të tjerat thotë: "Shqipëri dhe shqiptarët i njoha nëpërmes fytyrës së Nënë Terezës. e cila me solli në Shqipëri!"

Ne, sot mburremi me krenari për këtë Nënë të Madhe, për këtë Shënjetore, e cila e bëri kombin tonë një komb të rrespektuar dhe të admiruar në botë! Anjezë Gonxhe Bojaxhi, ose Nënë Tereza, lindi në Shkup më 26 gusht të vitit 1910 dhe vdiq në moshën 87 vjeçare, më 5 shtator 1997 në Kalkuta të Indisë. Ajo ishte humaniste e njohur shqiptare dhe fituese e çmimit 'Nobel' për Paqen.

Në këtë ditë të shënuar për shqiptarët dhe jo vetëm, nuk ka munguar edhe një koment i kryeministrit Rama në 'Facebook' i cili na ka uruar për ditën e "Lumturimit" të Nënë Terezës.

Korrespondenti i gazetës "Dukagjini"



## U BE NJE VIT QE PUSHON NE PAQE

Të nderoshe e të respektoshe të vdekurit është obligim, prandaj ka mbetur fjala jetoshi e i kujtoshtë të vdekurit. Pra u bë një vit kur u nda nga jeta Prenda Lulash Ortegu. Nëna e 6 djemeve dhe dy vajzave, gruaja Luk Tom Ortegut. Lindi në fshatin Lekaj të Shalës në një familje të njohur e të respektuar jo vetëm në Dukagjin por edhe më gjërë në familjen e Lulash Mal Vuksanit. Gjithashtu u martue në një familje të njohur të Thethit. Në shtëpinë e Mark Martinut të Okolit.

Edhe pse tani kalojë një vit, kujtohet me shumë respekt e dashuri sepse gjithë jetën ajo rezatojë të tillë respekt. Se ishte shtëpiake, bashkshorte e nënë shembullore. Ata rriten dhe edukuan 8 fëmijë të me veshtirësi, sepse krahas veshtirësive ekonomikme atyre u shtoi

heshin edhe ato politike. Biografia që i ndoqi si hije ogurzezë për rreth 45 vjet nuk ishte e lehtë.

Pavasisht se u nda nga jeta në moshë të madhe, sot në një vjetor në syt e djemeve vajzave niperve e mbesave, rejave, vllazerve e kunatave. dallohet një dhembshuri e madhe. Nuk thonë kotë se kur i moshuari vdes leshonë vend shume. Prandaj ata sot janë të perlotur. Për ta respektuar këtë familje e për ti shprehur ngushllimet bënë vizita me dhjetra e dhjetra persona jo vetem të afërm e fisi, por shumë miq e shok e komëshi. Dua të theksojë se nuk ishte bërë njoftim në mediat e shkruara as ato vizive. Kishin ardhë në këtë pervjetor djemët e vajzat të cilët punojnë e jetojnë në Europë deri në Amerikën e largët. Pas vendosjes se kurorave tek varri i të ndjerës, me gjithë kerkesen që u bënë djemët e në veçanti Gjergji e Lazri ishin të pakët ata

të cilët qendruan për drekë. Ne kemi vazhduar siç kemi vepruar edhe në raste të tjera. Nuk kemi bërë njoftime, por ata që e kanë mbajtur mendë datën me gjithë qef ju kishim organizuar një drekë të thjeshtë në respekt të nënës sonë që



aq shumë e kemi dashur e respektuar. Në bisedë e sipër shumë të pranishë u shprehen se i ka dale koha organizimit të një vjetorëve në raste vdekjesh. Për ar-

syse se krahas shpenzimeve jo të pakta të bëra nga familja që mesatarisht i shkonte deri në 225000 lekë të rinjë. Këto janë shpenzimet familjes të ndjerës. Po edhe atyre të cilëve i njofton direkt dhe atyre të cilët e kanë marrë vesh nga mediat autovizive. Detyrohen të lënë ditën e punës e të udhetojnë nga ana e anës duke bërë shpenzime.

Perseri bisedat vazhduan dhe tehu i tyre ishte se duhet të hequr dore një here e mire nga drekat për një vjetor, madje edhe kufizime për ditën e tretë.

Në mes të tjerash u tha se veprimet e bëra në raste vdekjesh nga Bajza e Kastratit kur nuk qesen vetem duhan e nga një gotë raki dhe nuk i pranojnë as shpenzime. Kjo ne ditën e varrimit, pra nuk bëhet fjalë për të tretat apo një vjetor. Shpesh janë marrë edhe here të tjera inisiativa të tilla Duhet pergjithsuar e marrë vendime të kesaj na tyre.

Nga Ndue Ziçi

### REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh PRODUCTION Kimay Produzione Giacche

